

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje matesa uji elektronike per qytetin e Korçës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **38421100-3**

VLERA E FONDIT LIMIT:

9.977.782,95 (Nente milion e nenteqind e shtatedhjete e shtate mije e shtateqind e tetedhjete e dy presje nentedhjete e pese) Leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce Sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4 ne vleren **199.555,65 Leke (Njeqind e nentedhjete e nente mije e peseqind e pesedhjete e pese presje gjashtedhjete e pese) Leke;***

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojces 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Objekti i prokurimit te jete i pasqyruar dhe ne ekstraktin e shoqerise persa i perket veprimtarise

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, dhe 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar .

Kerkesa lidhet ngushte me objektin e kontrates, cka paraqet domosdoshmerine e objektit te veprimtarise te OE .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera minimale e xhiros te jete sa 40% e vleres se parashikuar te kontrates

Baza ligjore (VKM nr.285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 43, pika 1 "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹"; neni 43, pika 2/c "40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme"

Neni 55/4 Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor .

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK veprimtaria financiare dhe vazhdueshmëria në fushën e veprimtarisë të OE.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros mesatare te 3 viteve te fundit financiare eshte percaktuar 3.991.113,18 (Tre milion e nenteqind e nentendhete e nje mije e njeqind e trembedhete presje tetembedhete)

Leke pasi kjo vlere perben 40% te fondit limit dhe eshte ne kufirin e lejuar nga legjislacioni ne fuqi sipas nenit 55, pika 4 paragrafi II te VKM nr. 285, dt 19.05.2021 ndryshuar. Vlera prej 9.977.782,95 (Nente milion e nenteqind e shtatedhjete e shtate mije e shtateqind e tetedhjete e dy presje nentedhjete e pese) Leke eshte vlera e perlllogaritur e fondit limit duke konsideruar si kriter te permbushur nese ne te pakten nje vit nga ato te kerkuara arrihet kjo vlere e xhiros.

Qellimi i vendosjes se ketyre kriterëve eshte qe AK te kete mundesi te krijojë idene e veprimtarise ekonomike te OE pjesemarres si dhe te mundesise qe ata kane te permbushin kontraten.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" neni 29 ku percaktohet se cdo tatimpagues eshte i detyruar te paraqite deklaraten e te ardhurave vjetore prane organeve tatimore brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet financiare te fundit perkatesist per vitin 2021,2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ... *(shëno bazën ligjore)*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate ose 1.995.556,59 (Nje milion e**

nenteqind e nentedhjete e pese mije e peseqind e pesedhjete e gjashte presje pesedhjete e nente) Leke pa TVSH

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Baza ligjore e detajuar (VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ndryshuar neni 40, pika 4 “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Neni 55/4/b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që

prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Ky kriter vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike dhe ka si qëllim të provohet para AK veprimtaria në objektin e prokurimit, çka rrit besueshmërinë e OE për realizimin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera 20% e fondit limit është përcaktuar bazuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr.285, dt. 19.05.2021, ndryshuar dhe është përcaktuar duke u lene mundesi bizneseve të nivelit të mesëm ose të vogël të konkurrojnë në kete procedure. Kjo kerkese pervecse provon faktin qe OE kane kryer furnizime te ngjashme te mallrave objekt prokurimi eshte vendosur ne raport me natyren e kontrates dhe vleren e perlllogaritur te saj.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme _____ të lëshuar nga _____ (shënim-përcaktoni, **nëse parashikohet** nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

_____.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

a. Nje inxhinier hidroteknik te pakten ne muajt Tetor – Nentor 2024, provuar me listpagesat

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

b. Listpagese e shoqerise per muajt Tetor – Nentor 2024

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektivit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **5 personash te pakten ne muajt Tetor – Nentor 2024, provuar me listpagesat**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kerkuar ka lidhje te ngushte me objektin e kontrates pasi eshte i mjaftueshem per permbushjen e saj dhe transportin ne objekt te mallrave te kerkuara nga AK.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

I- Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 dhe 14001:2015 për Menaxhimin e Cilësisë, ose e përditësuar ku te jete pasqyruar objekti i prokurimit dhe mdikimin ne mjedis. (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave te mallrave qe do te marre persiper sipas akt-marreveshjes.) Në rast se certifikata është në gjuhe të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

Baza ligjore (VKM nr.285, datë 19,05,2021, ndryshuar neni 44, pika 1” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato

janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Argumentimi: Ky kriter vendost për arsye se OE që vepron në fushën e objektit të prokurimit nëpërmjet kësaj certifikate duhet të jetë garantues sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij si dhe te rasteve te ndikimit ne mjedis.

II. MATESAT ELEKTRONIKE (me permasa 1/2 ” dhe 3/4” te klases R250)

a) Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentim :ky kriter vendost pasi provon vijueshmërinë dhe besueshmërinë e OE në fushën e prokurimit,pasi ky OE rezulton të jetë klient i vazhdueshëm për mallrat objekt prokurimit. Kriteri i vlerësimit nga AK është oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

b) Operatori Ekonomik duhet qe ne momentin e dorezimit te paraqese certifikatat ISO: 9001-2015

Argumentim: Në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO 9001-2015 të prodhuesit në momentin e dorëzimit të mallit sqarojmë paraprakisht se ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit të tij.

-Per pikat II a dhe II b te dorezohet fillimisht ne SPE nje deklarate e plotesuar nga OE ku te pasqyrohet emri i prodhuesit/distributori dhe fakti qe jane te pajisur me certifikatat e kerkuara sipas pikave perkatese.

Dokumentat do te dorezohen nga OE i klasifikuar i pari brenda 5 ditesh nga njoftimi i klasifikimit ne SPE. Ky kriter bazohet ne nenin 97/1 te ligjit nr.162/2020 dhe neni 31/1 te VKM nr.285 dt 19.05.2021, ndryshuar. Pasi AK do te publikoje ne SPE klasifikimin

perfundimtar OE i klasifikuar i pari do te paraqite dokumentat e kerkuar ne DST. Ne keto kushte AK do te publikoje njoftimin e fituesit duke i hapur rruge fillimit te afateve te aknikmit administrativ.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE MATESAVE ELEKTRONIKE

Materialet e kerkuara duhet te jene cilesore dhe te pershtateshme per montimin e tyre ne objektet e kerkuara. Materialet do vendosen set ose pjese-pjese duke i gershetuar dhe me materialet qe aktualisht jane duke punuar. Prandaj nevojitet qe ato te kene specifikimet teknike kryesore si me poshte:

SPECIFIKIMET ELEKTRONIKE TË MATËSIT

Teknologjia e identifikimit të rrjedhjes	Leximi i turbinës nëpërmjet sistemit induktiv
Temperatura e ujit gjate punes	0.1°C ~ 50°C uji i ftohte, 30°C ~ 90°C uji i ngrohtë

Temperatura e magazinimit	-20°C ~ 70°C
Ekrani	LCD, 8 numra + ikona
Mbrotja	IP68*
Standartet	Në varësi të versionit: - Wireless MBUS EN 13757-4 OMS ose Standardi Shqiptar ekuivalent, Matësat duhet të kenë dhe çertifikimin CE
Frekuenca Radio (MHz)	Frekuenca: 868, 921 (MHZ) Radio marrës që të mbledhë informaconet e leximeve dhe transmeton tek sistemi operativ i smartphone duke u lidhur me bluetouth
Largësia e transmetimit	300 metër
Bateria	Minimum 10 vjet, maksimum 13 vjet
Të tjera	Të jetë një trup (antena e transmetimit të jetë e inkorporuar në trupin e matësit) I pa aksesueshëm I pa modifikueshëm Frekuenca 868, 921(MHZ) Sensor në sens të kundërt Kundër fushës magnetike Të transmetojë në çdo pozicion që matësi montohet (360°) <i>Të ketë të integruar sistemin MBus</i>
Të dhënat e transmetimit	Leximin e konsumit Përqindja e baterisë Të dhëna për rrjedhjen e ujit në anën e

	<p>kundërt</p> <p>Gabimet</p> <p>Temperatura e ujit</p> <p>Datën e alarmeve (tubo bosh, humbje, ngrirjen e ujit, etj.)</p>
--	--

SPECIFIKAT ELEKTRONIKE TË MARRËSIT (RECEIVER)

Temperatura	Nga -10°C deri +55°C
Frekuenca e transmetimit	WMBUS Standard EN13757-4, T1(Rx), 867/ 868 / 921 MHz** ose Standardi Shqiptar ekuivalent
Mbrojtja	IP54
Energjia	LiPo 3.7V 3300mAh
Mbulimi i sinjalit	Deri në 300 metër
Transmetimi	Bluetooth 5.1
Antena WMBus	E inkorporuar ose e jashtme
Lidhjet	USB Type-C (vetëm për karikimin e baterisë) 5 V 2Ah
Të tjera	Marrësi të ketë një aplikacion specifik që mund të gjendet ne Play Store, që të mundësohet hedhja e të dhënave

Harta e fushës së transmetimit :

Matës -> Marrës (Receiver) -> Smartphone (Aplikacion) -> Sistem

SPECIFIKAT HIDRO-MEKANIKE TË MATËSIT

Përmasa DN (Diametri nominal)	mm (inç)	15 mm (1/2")	20 mm (3/4")
Gjatësia e trupit të matësit	mm	80/110/145/165	130/190
Prurja maksimale Q4	m3/h	3,12	5
Prurja e punës Q3	m3/h	2,5	4

Prurja tranzistore Q2	litër/h	16	25,6
Prurja minimale Q1	litër/h	10	16
Klasa e matësit R=Q3/Q1	-	250	250
Leximi minimal	litër	2	3
Leximi maksimal	m3	99 999	99 999
Presioni maksimal i punës	bar	16	16

Q1 - Prurja minimale për të cilën rezultatet e matjes janë të sakta

Q2 - Prurja tranzistore që nënkupton fashën mes prurjes minimale dhe asaj të punës

Q3 - Prurja e punës për të cilën është dizenuar matësi dhe që ka saktësinë më të lartë

Q4 - Prurja maksimale për të cilën rezultatet e matjes janë të sakta

Klasa e matësit (R) është raporti mes prurjes së punës dhe asaj minimale, pra $R=Q3/Q1$ dhe duhet të jetë 250. Kjo klasë garanton gabime të pa përfillshme në matje në të gjitha tipologjitë e punës së matësit.

1. Argumentim

Vendosja si kusht që matësat të jenë të certifikuar me certifikate për përdorim në bashkimin evropian (CE), garanton blerësin që i ofrohet një produkt cilësor. Është kërkuar dhe vendosja e karakteristikave të tjera elektronike dhe hidraulike në mënyrë që saktësia e matjes të jetë maksimale, jetegjatesia e produktit të jetë e lartë dhe mirëmbajtja të jetë me kosto shumë të ulët. Komunikimi me profilet e përshkruara më lart garanton thjeshtësi në përdorim dhe kursim të kohës në marrjen e leximeve. Vlerat e kërkuara të temperaturës së punës dhe magazinimit i përshkruan kushteve klimatike të terrenit ku do të përdoren këta matës.

“Blerje matës uji elektronik për qytetin e Korçës”

Nr	EMERTIMI	Njesia	Sasia
1	Mates uji elektronik 1/2” R250	cope	505
2	Mates uji elektronik 3/4” R250	cope	300

Pas dorëzimit të matësve do të bëhet testimi elektronik i tyre pa u cenuar paketimi original, në rast se testimi do të rezultojë pozitiv do të vijohet me procedurën e magazinimit pranë AK – Magazina e Shoqërisë Rajonale Korçe. Afati i zbatimit të kontratës të jetë **3 (tre) javë** nga data e nënshkrimit të saj.

Hartoi

Thoma Koroveshi (Inxhinier Hidroteknik)

Paoljo Zegullaj (Specialist IT)

Ada Lumani (Jurist)